

Vaksinimi përforcues

- Komisioni i Përhershëm i Vaksinimit rekomandon një vaksinim përforcues me një vaksinë mRNA për të gjithë personat e moshës 18 vjeç e lart.
- Për këtë, vaksinimi i dytë duhet të ketë ndodhur së paku gjashtë muaj më parë.
- Përparësi në vaksinimin përforcues kanë:
 - Personat në moshën ≥ 70 ,
 - Personat që marrin trajtim, përkujdesje apo që edhe jetojnë në ambientet e institucionit të përkujdesjes, në subjektet e asistencës së integritimit dhe në institucionet me grupe vulnerabël, si edhe
 - Personat me mungesë imuniteti.
- Për vaksinimin përforcues, ju lutemi sillni me vete vërtetimin e vaksinimit të parë dhe të dytë dhe një dokument identifikimi.

Keni pyetje?

- Numri i telefonit 116 117
- www.zusammengegencorona.de
- www.rki.de
- www.dranbleiben-bw.de



Informacione të tjera aktuale

mund të gjeni edhe në faqen tonë të internetit www.alb-donau-kreis.de



Ju urojmë shëndet.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.



Autorësia

Botues:
Paraqitja dhe tipografia:
Përkthimi:
Fotografite:
Shtypja:

© 11/2021: Zyra e Qarkut Alb-Donau-Kreis – Departamenti për të rinjtë dhe çështjet sociale /refugjatët, integrimin, ndihmat shtetërore;
Johannes Kiefer;
ORBIS Fachübersetzungen
blackday, rido, ocskay mark (të gjitha stock.adobe.com)
WIRmachenDRUCK GmbH, Backnang



ALBANISCH



INFORMACION PËR VAKSINIMIN KUNDËR KORONAVIRUSIT BOTIMI 2.0

Departamenti i Rinisë dhe Çështjeve Sociale

Shërbim special për refugjatët,
integrimin, ndihmat shtetërore



Të dashur bashkëqytetarë, dhe bashkëqytetare,

në këtë fletëpalosje do të gjeni informacione të rëndësishme për vaksinimin kundër koronavirusit.

Vaksinimi është mënyra më e sigurt për të krijuar mbrojtje kundër koronavirusit. Vaksinimi mund të parandalojë përkeqësimin e sëmundjes.

Në këtë mënyrë ju mbron veten, familjen tuaj dhe, për shembull, edhe të moshuarit dhe të sëmurët.

Vaksinimi është një nga masat më të thjeshta dhe më efektive për t'u mbrojtur nga koronavirusi.

Çdo person i vaksinuar ndihmon për të lehtësuar sistemin shëndetësor, për shembull, spitalet tona. Dhe ne të gjithë shpresojmë që të mund të kthehemi hap pas hapi në normalitet.

Mbrojtja e përhershme kundër koronavirusit është e rëndësishme. Kjo arrihet kur shumë njerëz vaksinohen kundër koronavirusit.

Prandaj, ju lutemi, vaksinohuni!

Ulm, 19 nëntor 2021



Informacione të rëndësishme

Kush mund të vaksinohet:

- Komisioni i Përhershëm i Vaksinimit (STIKO) rekomandon vaksinimin nga moshë 12 vjeç, nëse nuk ka arsye mjekësore për të kundërtën

Ku mund të vaksinohem?

- Tek mjeku i familjes ose specialisti
- Tek mjeku privat
- Tek mjeku i kompanisë
- Tek fushatat e vaksinimit në terren

Kush paguan për vaksinimin?

- Vaksinimi është falas.

Çfarë dokumentesh duhet të sjell me vete në takimin për vaksinim?

- Certifikatën e vaksinimit (nëse disponohet)
- Karta e sigurimit shëndetësor/fleta e informacionit, për t'i paraqitur tek mjeku
- Dokument identiteti (leje qëndrimi, miratim qëndrimi, statusin Duldung, pasaportë, etj.)

Vaksinimi

- Të gjitha vaksinat e aprovuara janë efektive dhe, sipas gjendjes aktuale të shkencës, me rrezik të ulët.
- Shumica e vaksinave kërkojnë një vaksinim të dytë pas disa javësh.
- Personat e vaksinuar ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së koronavirusit.
- Në shumicën dërrmuese të rasteve, vaksinimi mbron të mos sëmurësh rëndë.

